



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. B44 Prot.

Tiranë, më 19.062017

VENDIM Nr. 130, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*Objekt multifunksional 10 kat, (2 kate shërbime dhe 8 kat banim) dhe 2 kat parkim nëntokë, ndodhur në kryqëzimin e rrugës "Mujo Ulqinaku" me rrugët "Andon Naci dhe "Hajdar Dushi" deri në ndërprerjen me rrugën "Dalip Tabaku", Durrës, zona arkeologjike "B", - subjekti "RAJFI" sh.p.k. realizuar nga Instituti i Arkeologjisë.*

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*Objekt multifunksional 10 kat, (2 kate shërbime dhe 8 kat banim) dhe 2 kat parkim nëntokë, ndodhur në kryqëzimin e rrugës "Mujo Ulqinaku" me rrugët "Andon Naci dhe "Hajdar Dushi" deri në ndërprerjen me rrugën "Dalip Tabaku", Durrës, zona arkeologjike "B", - subjekti "RAJFI" sh.p.k. realizuar nga Instituti i Arkeologjisë, duke plotësuar përcaktimin e pikës 2 dhe 3 të këtij vendimi.*
2. Për 6 varret mesjetare të identifikuara nga sondazhet arkeologjike të realizuar nga Instituti i Arkeologjisë, të kryhet nga ky Institut gërmimi arkeologjik i shpëtimit, nën mbikëqyrjen e ASHA.
3. Për pjesën tjetër të sheshit të ndërtimit të objektit të sipërpërmendur, subjekti "RAJFI" sh.p.k. të kontraktojë shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të paraqesë në KKA e radhës konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRCELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO